


PROKURORIA E PËRSHITËS SË KOSOVËS
KOSOVSKA PROKURATURA
CE. REKTORATI - SEKRETARIJAT
ARKIVA - ARHIVA
01 -11- 2024
Nr./Br. 1864, 2024
PRISHTINË - PRIŠTINA

RAPORTI FINAL I PROCESIT REKRUTUES



Prishtinë, tetor 2024

RAPORT

PËR PROCESIN E REKRUTIMIT DHE PROVIMIT TË KANDIDATËVE PËR PROKURORË TË SHTETIT

Përmbajtja

HYRJE.....	3
II. KONKURSI	4
III. BAZA LIGJORE	4
IV. VEPRIMET DHË VENDIMET PARAPRAKE	4
V. PERZGJEDHJA PRELIMINARE.....	5
VI. STRUKTURA E PROVIMIT PËR PROKURORË.....	6
Qëllimet dhe objektivat e secilës pjesë të provimit.....	7
Pjesa 1, (Testi Kualifikues)	7
Pjesa 2, (Testi me Shkrim)	7
Pjesa 3, (Intervista)	7
VII. HARTIMI I TESTIT KUALIFIKUES.....	7
Ruajtja e fshehtësisë dhe siguria	8
VIII. PUBLICITETI DHE TRANSMETIMI I TË DHËNAVE TEK KANDIDATËT	9
IX. ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI I TESTIT KUALIFIKUES	9
X. VLERËSIMI I TESTIT KUALIFIKUES	10
XI. SHPALLJA E REZULTATEVE TË TESTIT KUALIFIKUES	11
XII. TESTI ME SHKRIM.....	11
XIII. VLERËSIMI I TESTIT ME SHKRIM	12
XIV. SHPALLJA E REZULTATEVE TË TESTIT ME SHKRIM	13
XV. PROCESI I VLERËSIMIT TË INTEGRITETIT PERSONAL DHE AFTËSIVE PROFESIONALE TË KANDIDATËVE.....	14
XVI. INTERVISTA	14
XVII. REZULTATET PRELIMINARE.....	15
XVIII. KOMISIONI PËR RISHQYRTIM.....	15
XIX. PROPOZIMI I LISTËS SË KANDIDATËVE NË KËSHILLIN PROKURORIAL TË KOSOVËS.....	15
XX. MASAT E VEÇANTA, TË NDËRMARRA PËR TË ARRITUR STANDARDET NDËRKOMBËTARE	16
XXI. FALËNDËRIM PËR MBËSHTETJE	17
XXII. PËRFUNDIM	17

HYRJE

Neni 110 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK) si institucion plotësisht të pavarur në kryerjen e funksioneve të tij dhe me mandat për rekrutimin, propozimin, avancimin, transferimin dhe disiplinimin e prokurorëve, në mënyrën e rregulluar me ligj.

Me Rregulloren nr. 02/2022 për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Prokurorëve të Shtetit, të miratuar nga KPK-ja, më 17 qershor 2022, janë përcaktuar kriteret dhe procedurat për organizimin e provimit dhe procesit të rekrutimit të kandidatëve për prokurorë të Shtetit.

Mbështetur në mandatin ligjor, KPK-ja ka organizuar provimin dhe ka zhvilluar procesin e rekrutimit të Prokurorëve të Shtetit.

Raporti pasqyron në mënyrë të detajuar gjithë procesin e rekrutimit të Prokurorëve të Shtetit, e deri në publikimin e listës përfundimtare të kandidatëve të cilët e kanë kaluar provimin për prokurorë.

Si qëllime kryesore të këtij raporti janë:

- Paraqitja në mënyrë publike dhe transparente e punës së Këshillit Prokurorial të Kosovës, përkatësisht Komisionit për Rekrutim dhe Komisionit për Rishqyrtim, në procesin e rekrutimit të Prokurorëve të Shtetit;
- Shpjegimi i progresit të arritur gjatë procesit të organizimit dhe administrimit të provimit për kandidatët për Prokurorë të Shtetit;
- Njoftimi me historikun e shkurtër të zhvillimit të provimit për prokurorë të Shtetit dhe sfidat organizative;
- Publikimi i vendimeve/veprimeve që i paraprinë implementimit të provimit për Prokurorë të Shtetit;
- Paraqitja e detajuar e të gjitha fazave të zbatimit të provimit për Prokurorë të Shtetit dhe
- Prezantimi i masave të veçanta që u ndërmorën nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, për të arritur standardet ndërkombëtare në organizim të këtij provimi.

II. KONKURSI

Këshilli Prokurorial i Kosovës, më 15 janar 2024, mori vendim për shpalljen e njëzetetë (28) pozitave të lira për prokurorë të Shtetit, prej tyre katër (4) pozita të rezervuara për komunitetin serb.

Konkursi u hap më 22 janar 2024 dhe vazhdoi deri më 06 shkurt 2024. Të gjithë të interesuarit janë njoftuar se mund të aplikojnë në formë fizike, përmes postës së rregullt, postës elektronike (e-mail) si dhe aplikimit online (aplikacioni elektronik). Aplikuan katërqindnjëzetetë (428) aplikues, prej tyre dyqindedy (202) aplikuese femra dhe dyqindnjëzetegjashtë (226) aplikues meshkuj, ndërsa katër (4) prej tyre nga komuniteti jo shumicë.

Të gjitha aplikacionet janë regjistruar në detaje në data bazën e brendshme të Zyrës për Verifikim Prokurorial.

III. BAZA LIGJORE

Në bazë të nenit 7, paragrafi 1, pika 1.7 të Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, parashihet që KPK-ja vendos për organizimin e provimit për kandidatët për prokurorë, sipas rregullores së miratuar nga Këshilli.

Këshilli Prokurorial i Kosovës, më 17 qershor 2022, ka miratuar Rregulloren nr. 02/2022 për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Prokurorëve të Shtetit, me anë të së cilës përcaktohen rregullat dhe procedurat për procesin e rekrutimit të prokurorëve të Shtetit.

IV. VEPRIMET DHE VENDIMET PARAPRAKE

Në bazë të nenit 16 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës mund të themelojë edhe komisione të tjera të përkohshme ose të përhershme sipas nevojës.

Në pajtim me Rregulloren nr. 02/2022 për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Prokurorëve të Shtetit, Këshilli Prokurorial i Kosovës, më 15 janar 2024, ka miratuar përbërjen e Komisionit për Rekrutim, anëtarëve rezervë të këtij Komisioni dhe përbërjen e Komisionit për Rishqyrtim dhe anëtarëve rezervë si në vijim:

Komisioni për Rekrutim kishte këtë përbërje:

- z. Aleksandër Lumezi, Kryesues i Komisionit për Rekrutim;
- z. Ardian Hajdaraj, anëtar;
- znj. Jehona Grantolli, anëtare;
- z. Armend Zenelaj, anëtar;
- z. Blerim Isufaj, anëtar.

Anëtar rezervë:

- znj. Arijana Shajkovci, dhe
- z. Idain Smailji.

Komisioni për Rishqyrtim kishte këtë përbërje:

- z. Arian Gashi, Kryetar i Komisionit;
- z. Bahri Hyseni, anëtar dhe
- znj. Bedrie Alshiqi, anëtare

Anëtarë rezervë:

- znj. Merita Bina-Rugova dhe
- z. Arben Ismajli

Kryetari i Komisionit z. Aleksander Lumezi ka ofruar dorëheqje e cila dorëheqje është aprovuar nga ana e Këshillit më datën 19.03.2024.

Këshilli ka caktuar anëtarin e ri të Komisionit për Rekrutim z. Zejnullah Gashi, ndërsa z. Blerim Isufaj është caktuar Kryetar i Komisionit.

Gjithashtu, nga Komisioni për Rishqyrtim është tërhequr anëtarja znj. Bedrije Syla Alshiqi.

V. PERZGJEDHJA PRELIMINARE

Pas përfundimit të konkursit dhe regjistrimit të aplikacioneve nga Zyra për Verifikim Prokurorial, Komisioni për Rekrutim ka bërë edhe përzgjedhjen preliminare të aplikacioneve të cilët i plotësonin kriteret e përcaktuara në konkurs.

Nga katërqindnjëzetetë (428) aplikues, këtë fazë nuk arritën ta kalojnë vetëm njëzetë (20) aplikues.



Takimi i parë i Komisioni për Rekrutim-Përzgjedhja preliminare

Komisioni për Rekrutim vendosi që të gjithë aplikuesit të njoftohen individualisht për arsyen e refuzimit të aplikacioneve të tyre si dhe me të drejtën e kundërshtimit të njoftimit të Komisionit për Rekrutim.

Komisioni për Rishqyrtim ka pranuar gjithsejtë pesëmbëdhjetë (15) ankesa, nga të cilat ka aprovuar katërmëdhjetë (14) prej tyre dhe vetëm një (1) ankesë e ka refuzuar.

Pas përfundimit të fazës së ankesave, Komisioni për Rekrutim publikoi listën finale sipas së cilës, Testit Kualifikues do t'i nënshtroheshin katërqindnjëzetedy (422) kandidatë.



Takim i parë i Komisionit për Rishqyrtim të ankesave ndaj përzgjedhjes preliminare

VI. STRUKTURA E PROVIMIT PËR PROKURORË

Sipas Rregullores 02/2022, provimi për kandidatët për prokurorë, është përbërë nga tri pjesë, si në vijim:

1. Pjesa e parë ka përfshirë Testin Kualifikues;
2. Pjesa e dytë ka përfshirë Testin me Shkrim dhe

3. Pjesa e tretë ka përfshirë Intervistën.

Qëllimet dhe objektivat e secilës pjesë të provimit

Pjesa 1, (Testi Kualifikues)

Kjo pjesë e provimit ishte dizajnuar për të vlerësuar aftësitë e përgjithshme të kandidatëve nga fusha penale, etika profesionale dhe të drejtat e njeriut dhe kishte gjithsejtë 60 pyetje me përgjigje alternative. Për t'u kualifikuar, kandidatët duhej të kishin së paku 45 pikë, përndryshe nuk do të kualifikoheshin.

Pjesa 2, (Testi me Shkrim)

Kjo pjesë e provimit përfshinte një detyrë me shkrim, që përfshinte një rast praktik nga lëmia penale (materiale dhe procedurale).

Provimi me shkrim kishte gjithsejtë 50 pikë dhe konsiderohej se kandidati për të kaluar këtë fazë duhet të marrë së paku 30 pikë.

Pjesa 3, (Intervista)

Intervista përmbante pyetjet që vlerësojnë integritetin personal dhe profesional të kandidatit, njohuritë për legjislacionin dhe aftësitë e komunikimit.

VII. HARTIMI I TESTIT KUALIFIKUES

Komisioni për Rekrutim, në ditën e mbajtjes së Testit Kualifikues, në ndërtesën e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, ka hartuar testin me 60 pyetje me përgjigje alternative.

Të pranishëm gjatë hartimit të Testit Kualifikues ishin edhe monitoruesit nga EULEX-i dhe OSCE-ja.

Të ftuar, po ashtu, të marrin pjesë në këtë organizim kanë qenë të gjitha mediumet dhe organizatat e shoqërisë civile.

Para se të fillonte hartimi i testit, të pranishmit kanë nënshkruar një Deklaratë mbi Konfidencialitetin.



Komisioni gjatë hartimit të testit kualifikues

Përkthimi në gjuhën serbe i testit të hartuar është bërë nga përkthyesit e KPK-së dhe në prezencën e Komisionit për Rekrutim.

Kompjuterët ku është punuar Testi Kualifikues nuk kanë pasur lidhje interneti dhe komunikimi me telefon gjatë kohës së hartimit të provimit ka qenë i ndaluar nga të gjithë pjesëmarrësit.

Procesi i fotokopjimit është kryer nga stafi mbështetës në ndërtesën e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, në prani të Komisionit për Rekrutim dhe të monitoruesve ndërkombëtar.



Ndarja e detyrave mbikqyrëse të sallave

Për të mbështetur të gjithë mbarëvajtjen e Testit Kualifikues, janë ftuar edhe Kryeprokurorë, zëvendëskryeprokuror, prokurorë nga Prokuroria e Apelit, Prokuroria Speciale si dhe prokuroritë themelore në cilësinë e mbikëqyrësve të sallave.

Ruajtja e fshehtësisë dhe siguria

Ruajtja e fshehtësisë lidhur me pyetjet dhe përgjigjet e provimeve është konsideruar si çështje me prioritet të lartë për KPK-në dhe Komisionin për Rekrutim. Janë aplikuar rregulla dhe procedura të rrepta për t'u siguruar që asnjë e dhënë lidhur me pyetjet apo përgjigjet e provimit të mos i bëhet e ditur askujt, siç përcaktohet me Rregulloren nr. 02/2022 për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Prokurorëve të

Shtetit. Kjo është bërë për t'u siguruar që asnjëri prej kandidatëve të mos ketë përparësi ndaj kandidatëve të tjerë.

Secili pjesëmarrës, duke filluar në takimin e përzgjedhjes preliminare dhe deri në hartimin e Testit Kualifikues, ka nënshkruar marrëveshjen mbi ruajtjen e fshehtësisë, duke u zotuar për mos zbulimin e asnjë të dhëne lidhur me pyetjet dhe përgjigjet e provimit dhe duke iu përmbytur tërësisht rregullave dhe procedurave të sigurisë.

VIII. PUBLICITETI DHE TRANSMETIMI I TË DHËNAVE TEK KANDIDATËT

Kandidatët që kanë plotësuar kushtet për t'iu nënshtruar Testit Kualifikues janë njoftuar me rregullat edhe procedurën e provimit, vendin dhe datën e provimit, si dhe detajet e tjera nëpërmjet faqeve zyrtare të KPK-së dhe PSH-së, si dhe janë njoftuar individualisht me e-mail.

IX. ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI I TESTIT KUALIFIKUES

Testi Kualifikues, u mbajt më 19 maj 2024, në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP), në Vushtrri.

Nga katërqindënjëzetedy (422) kandidatët, të cilët kishin plotësuar kriteret për t'iu nënshtruar Testit Kualifikues, vetëm treqindëdyzetetë (348) kandidatë morën pjesë.

Nga ky numër i kandidatëve, tre (3) ishin nga komuniteti jo shumicë (dy boshnjak dhe një turk).

Regjistrimi i kandidatëve për t'iu nënshtruar Testit Kualifikues është bërë nga stafi administrativ i KPK-së në përputhje me Rregulloren. Për shkak të numrit të madh të kandidatëve janë përdorur 16 klasa dhe tri salla.



Njëra nga sallat e mbajtjes së Testit Kualifikues

Kandidatët ishin ndarë nëpër salla sipas renditjes alfabetike. Përrjashtimi i vetëm ishte për kandidatët që kanë zgjedhur të testohen në gjuhën serbe, ku ata janë udhëzuar të shkojnë në të njëjtën sallë, pavarësisht renditjes alfabetike.

Përveç Komisionit dhe stafit të autorizuar të KPK-së, në sallë kanë qëndruar edhe monitoruesit ndërkombëtarë.

Kandidatët janë njoftuar paraprakisht se janë të obliguar të marrin me vete dokumentin e identifikimit dhe nuk do t'u lejohet asnjë lloj dokumenti tjetër, ashtu siç është përcaktuar me Rregulloren.

Provimi është mbajtur nën drejtimin e Komisionit për Rekrutim, si autoritet për vendimmarrje përfundimtare, në rast të ndonjë shkelje apo kundërshtimi të rregullave, procedurave apo udhëzimeve të testit dhe stafit të KPK-së.

Secili kandidat është ulur në një tavolinë i vetëm dhe në tavolinë ka qenë i vendosur Udhëzuesi për rregullat e provimit për kandidatin.

Përveç zarfit në të cilën ishte vendosur pjesa e provimit, kandidatëve iu është shpërndarë edhe një zarf i vogël, brenda të cilit ishte një pjesë letër e zbrazët dhe e vulosur, ku kandidatët duhej të shënonin emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin.

Secilit zarf, në fund të Testit Kualifikues ju ka vendosur një kod në përputhje me Rregulloren.

Asnjë kandidat nuk ishte përjashtuar për shkak të mosrespektimit të rregullave dhe asnjë prej tyre nuk e ka kundërshtuar administrimin e provimit.



Komisioni për Rekrutim dhe stafi mbështetës pas përfundimit të Testit Kualifikues

X. VLERËSIMI I TESTIT KUALIFIKUES

Komisioni për Rekrutim, në ditën e mbajtjes së Testit Kualifikues, në hapësira të veçanta të KPK-së dhe me qasje vetëm për personat e autorizuar, pandërprerë dhe në mënyrë profesionale, ka vlerësuar Testin Kualifikues.

Në fillim, Komisioni verifikoi edhe një herë pyetjet dhe përgjigjet e sakta, për të cilat është përpiluar "çelësi" me përgjigjet e sakta.

Stafi mbështetës para Komisionit hapi vetëm zarfet e mëdha, në të cilët gjendeshin testet e kandidatëve. Pastaj, Komisioni, ka vlerësuar testet vetëm sipas numrit të vendosur në zarf. Në momentin e hapjes së zarfeve, secilit test brenda iu dha numri i njëjtë me zarfin.

Nga treqindedyzetetë (348) kandidatët, të cilët i ishin nënshtruar Testit Kualifikues, vetëm dyqindenëntëdhjetepesë (295) prej tyre kanë kaluar, pesëdhjetedy (52) të tjerët nuk e kanë kaluar testin, ndërsa një (1) kandidatë nuk është vlerësuar fare, pasi është diskualifikuar në përputhje me Rregulloren.

Pas vlerësimit të Testit Kualifikues dhe renditjes së poenëve, u hapën zarfet e vogla, në mënyrë që të bëhet renditja dhe shpallja e listës së kandidatëve, të cilët e kishin kaluar Testin Kualifikues.

XI. SHPALLJA E REZULTATEVE TË TESTIT KUALIFIKUES

Në përputhje me Rregulloren 02/2022, më 20 maj 2024, u publikua lista e kandidatëve që e kaluan dhe lista e kandidatëve që nuk e kaluan Testin Kualifikues.

Të gjithë kandidatët që morën pjesë në Testin Kualifikues, në përputhje me Rregulloren, u njoftuan se kishin të drejtë të shikojnë testet e tyre dhe të parashtronjë ankesë te Komisioni për Rishqyrtim deri më 23 maj 2024.

Qasjen në Testin Kualifikues e shfrytëzuan shtatëdhjetetë (73) kandidatë, ndërsa brenda afatit të pacaktuar ligjor, u pranuan nëntëdhjetë (90) ankesa.

Komisioni për Rishqyrtim u takua më datë 27 maj 2024 dhe shqyrtoi nëntëdhjetë (90) ankesa si dhe vendosi që shtatëdhjetenëntë (79) ankesa të aprovohen.

XII. TESTI ME SHKRIM


Testi me Shkrim, nën mbikëqyrjen e Komisionit për Rekrutim, u mbajt më 09 qershor 2024, në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, në Vushtrri, ku të pranishëm ishin edhe monitoruesit ndërkombëtarë, të cilët në vazhdimësi përcollën mbarëvajtjen e testit.



Hartimi i Testit me Shkrim

Regjistrimi i kandidatëve për t'iu nënshtruar Testit me Shkrim është bërë nga stafi administrativ i KPK-së, në përpunje me Rregulloren. Për shkak të numrit të madh të kandidatëve janë përdorur gjashtëmbëdhjetë (16) klasa.

Testit iu nënshtruan dyqindetëtdhjetenjë (281) kandidatë, pasi që katërmëdhjetë (14) ishin tërhequr në ndërkohë. Të gjithë kandidatëve iu siguroa nga një përmbledhje e ligjeve penale (materiale dhe procedurale).



Komisioni për Rekrutim gjatë mbikëqyrjes së Testit me Shkrim


E gjithë procedura e regjistrimit, administrimit, monitorimit, mbikëqyrjes dhe gjithë procesit të Testit me Shkrim, ka qenë e njëjtë me Testin Kualifikues, të mbajtur më 19 maj 2024.

XIII. VLERËSIMI I TESTIT ME SHKRIM

Nga data 10 qershor deri më 13 qershor 2024, në ambientet e KPK-së, në hapësira të veçanta me qasje vetëm për personat e autorizuar, Komisioni për Rekrutim vlerësoi Testin me Shkrim.

Të pranishëm gjatë hapjes së pakos së provimit dhe gjatë vlerësimit, ishin edhe monitoruesit e EULEX-it.

Vlerësimi i Testit me Shkrim është bërë në përputhje me Rregulloren 02/2022. Stafi mbështetës, para Komisionit hapi vetëm zarfet e mëdha, në të cilët gjendeshin testet e kandidatëve. Pastaj, Komisioni ka vlerësuar testet vetëm sipas numrit të vendosur në zarf. Në momentin e hapjes së zarfeve, secilit test brenda iu dha numri i njëjtë me zarfin.



Hapja e zarfeve dhe vendosja e numrit brenda testit

XIV. SHPALLJA E REZULTATEVE TË TESTIT ME SHKRIM

Nga dyqindetëdhjetenjë (281) kandidatët, të cilët iu nënshtuan Testit me Shkrim, shtatëdhjetedy (72) prej tyre kaluan këtë pjesë të provimit.

Pas vlerësimi të Testit me Shkrim dhe renditjes së poenëve, u hapën zarfet e vogla, në mënyrë që të bëhet renditja dhe shpallja e listës së kandidatëve, të cilët e kishin kaluar Testin me Shkrim.

Shpallja e rezultateve preliminare është bërë më 14 qershor 2024. Kandidatët u njoftuan individualisht se kanë të drejtë të parashetrojnë ankesë tek Komisioni për Rishqyrtim i KPK-së, brenda afatit të përcaktuar me Rregullore.

Të gjithë ankuesit, të cilët kishin kërkuar qasje në Testin me Shkrim, kjo iu mundësua dhe këtë të drejtë më 18 qershor 2024 e shfrytëzuan dyzetedy (42) prej tyre.

Gjithsejtë u pranuan pesëdhjetepesë (55) ankesa dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të tyre, Komisioni për Rishqyrtim vendosi të refuzojë të gjitha ankesat e ankuesve, si dhe i njoftoi individualisht të gjithë parashtruesit e ankesave.

XV. PROCESI I VLERËSIMIT TË INTEGRITETIT PERSONAL DHE AFTËSIVE PROFESIONALE TË KANDIDATËVE

Procedura e vlerësimit të integritetit personal dhe aftësive profesionale të kandidatëve, ashtu siç e parasheh edhe Rregullorja, bëhet përmes verifikimit të informatave të siguruar nga kandidati, si dhe çfarëdo informacioni tjetër relevant që vendos të kërkojë Komisioni për Rekrutim.

Pas procesit të verifikimit, të gjithë kandidatët u njoftuan për datën dhe kohën e intervistës dhe me të drejtën e përcaktuar me nenin 25.3 të Rregullores¹.

Këtë të drejtë e realizuan shumë nga kandidatët, të cilët shprehën interesim ta shikojnë dosjen e tyre personale dhe dokumentacionin e mbledhur rreth të kaluarës së tyre personale dhe profesionale.

XVI. INTERVISTA

Intervistat u zhvilluan nga data 09 deri më 13 shtator 2024. Nga shtatëdhjetedy (72) kandidatët të cilët kishin kaluar Testin me Shkrim, u intervistuan gjashtëdhjetekatër (64) kandidat pasi që tetë (8) prej tyre ishin tërhequr ndërkohë. Kandidatët u intervistuan duke iu parashtruar pyetjet standarde të parapara me Rregulloren 02/2022.

Intervista, vlerësimi i integritetit personal dhe aftësive profesionale sipas Rregullores, vlerësohet më së shumti 30 pikë, prej të cilave më së shumti 10 pikë janë të parapara për vlerësimin e kodit të etikës profesionale dhe integritetit personal.



Komisioni për Rekrutim gjatë mbajtjes së intervistave si dhe monitoruesit ndërkombëtar

¹ Neni 25.3 i Rregullores 02/2022-Kandidatet kanë të drejtë të njoftohen dhe t'i shikojnë dokumentet e mbledhura dhe draftdokumentacionin jo më herët se dhjetë 10 ditë dhe jo më vonë se pesë (5) ditë para mbajtjes së intervistës.

Pas përfundimit të intervistimit për secilin kandidat, anëtarët e Komisionit plotësuan formularin e vlerësimit, duke shënuar pikët për kandidatët në mënyrë individuale dhe nënshkruan vlerësimet e tyre.

Intervistat janë monitoruar nga përfaqësues të EULEX-it si dhe OSCE-së.

XVII. REZULTATET PRELIMINARE

Komisioni për Rekrutim, ditën e përfundimit të intervistave, ka përgatitur dhe shpallur rezultatet preliminare.

Rezultateve të Testit Kualifikues dhe Testit me Shkrim i janë shtuar edhe rezultatet e Intervistës dhe nga totali i këtyre rezultateve, është bërë edhe rangimi i kandidatëve më të suksesshëm, sipas nenit 28 pika 5 e Rregullores².

XVIII. KOMISIONI PËR RISHQYRTIM

Në përputhje me nenin 29 të Rregullores, kandidatët kanë pasur të drejtë të parashtrijnë ankesë brenda tre (3) ditëve, nga dita e publikimit të rezultateve preliminare të provimit.

Brenda afatit të përcaktuar me Rregullore, Komisioni për Rishqyrtim i Këshillit Prokurorial të Kosovës, ka pranuar katër (4) ankesa të cilat pas vlerësimit nga Komisioni për Rishqyrtim janë refuzuar.

XIX. PROPOZIMI I LISTËS SË KANDIDATËVE NË KËSHILLIN PROKURORIAL TË KOSOVËS

Në përputhje me Rregulloren për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Prokurorëve të Shtetit, Kryetari i Komisionit për Rekrutim do të përgatisë listën me propozimet e kandidatëve për Prokurorë të Shtetit nëpër prokuroritë themelore të Republikës së Kosovës.

Kjo listë do t'i dorëzohet Këshillit Prokurorial të Kosovës.

² Neni 28.5 i Rregullores 02/2022 "Renditja e kandidatëve të suksesshëm në listë, përfundon me numrin e kandidatëve të përcaktuar me shpallje (KONKURS) nga Këshilli"

XX. MASAT E VEÇANTA, TË NDËRMARRA PËR TË ARRITUR STANDARDET NDËRKOMBËTARE

Me qëllim të arritjes së standardeve më të larta për organizimin e provimit për prokurorë, Këshilli Prokurorial i Kosovës ka ndërmarrë këto masa:

- ✓ Testit Kualifikues dhe Testit me Shkrim janë hartuar, përkthyer dhe fotokopjuar ditën e mbajtjes së provimit;
- ✓ Testi Kualifikues ishte dizajnuar për të vlerësuar aftësitë e përgjithshme të kandidatëve nga fusha penale (materiale dhe procedurale), kushtetuese, etika profesionale dhe të drejtat e njeriut dhe kishte gjithsejtë gjashtëdhjetë (60) pyetje me përgjigje alternative. Për tu kualifikuar, kandidatët duhej të kishin së paku dyzetepesë (45) pikë, përndryshe nuk do të kualifikoheshin; Testi me Shkrim, përfshinte një rast praktik nga lëmia penale (materiale dhe procedurale). Ky test kishte gjithsejtë pesëdhjetë (50) pikë dhe konsiderohej se kandidati për të kaluar këtë fazë, duhet të marr së paku 30 pikë. Intervista përmbante pyetjet që vlerësojnë integritetin personal dhe profesional të kandidatit, njohuritë për legjislacionin dhe aftësitë e komunikimit;
- ✓ Fotokopjimi i testeve është bërë nga stafi mbështetës i KPK-së;
- ✓ Përkthimi i testeve është bërë në kompjuterë të veçantë të cilët nuk kanë qenë të lidhur në rrjet;
- ✓ Pasi që kandidatët kanë përfunduar provimin, në secilin zarf, është vendosur një numër, të cilin nuk e kanë ditur as kandidatët, e as anëtarët e Komisionit;
- ✓ Zarfet e vogla të mbyllura, kanë marrë numrin e njëjtë sikur zarfet e mëdha me teste dhe brenda tyre ka qenë i shënuar Emri, Mbiemri dhe Nënshkrimi i kandidatit;
- ✓ Testet janë vlerësuar nga anëtarët e Komisionit për Rekrutim, në mënyrë të paanshme dhe konfidenciale, pa njohur identitetin e kandidatëve;
- ✓ Testi Kualifikues, Testi me Shkrim dhe Intervistat janë mbikëqyrë nga monitoruesit ndërkombëtarë;
- ✓ Të gjitha materialet e nevojshme për realizimin e provimit, janë siguruar nga KPK-ja dhe kandidatët nuk janë lejuar të sjellin asgjë me vete gjatë provimeve.

XXI. FALËNDËRIM PËR MBËSHTETJE

Këshilli Prokurorial i Kosovës shpreh falënderim për përkrahjen e ofruar gjatë procesit të provimit nga institucionet vendore dhe organizatat si më poshtë:

- Akademia e Kosovës për Siguri Publike në Vushttri (ASKP);
- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE);
- EULEX;

XXII. PËRFUNDIM

Komisioni për Rekrutim i Këshillit Prokurorial të Kosovës ka hartuar, administruar dhe vlerësuar me sukses provimin për prokurorë për të gjithë kandidatët me profesionalizëm, paanësi dhe transparencë, përgjatë tërë procesit.

Rezultati i këtij procesi është përgatitja e listës përfundimtare drejtuar KPK-së, me emrat e kandidatëve të suksesshëm, të cilët do të propozohen Këshillit për votim.